

Data ___/06/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime mirëmbajtje dhe riparime 50000000-5; Lyerje 45442100-8.

VLERA E FONDIT LIMIT: 10,830,004 (dhjetë milion e tetëqind e tridhjetë mijë e katër) **Lekë pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar), autoriteti kontraktor Tirana Parking, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(e ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë. Ky kriter plotësohet me paraqitjen e vetedeklarimit në fazën e ofertimit. Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20 % e fondit limit.

- Kur shërbimi i një natyre të ngjashme është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë me vërtetime të lëshuara nga ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Kur shërbimi i një natyre të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë vetëm me fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët Ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP-3 A Rikonstrukcion dhe mirembajtje Godinash civile e Industriale

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma ”a” të VKM

nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë licensat profesionale të domosdoshme për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

2.3.3 Operatoret Ekonomike duhet te kene një punësim mesatar të paktën 18 (tetëmbëdhjetë) personave të siguruar për periudhen e 3 (tre) muajve të fundit.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit perbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi pasi dhe afati i shërbimit është 14 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës afati i cili kërkon patjetër këtë numër punonjësish për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

2.3.4 Operatoret Ekonomike duhet te kene pjese te stafit teknik te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise si me poshte:

a. Inxhinier Ndërtimi

1 (nje)

-Per stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare si dhe të figurojnë ne listepagesat e kompanise se minimalisht per periudhen 3 (tre) muajt e fundit.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit perbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

2.3.5 Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- Bojaxhi 14 (katërmbëdhjetë)
- Shofer 2 (dy)
- Punonjës për punime në lartësi 2 (dy)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesipërm: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmitë profesionale/ si dhe stafi i mesipërm të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 3 (tre) muajt e fundit.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmitë/certifikatat) që nuk është lëshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të metejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi pasi dhe afati i shërbimit është 14 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës afati i cili kërkon patjetër këtë numër punonjësish për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi..

2.3.6 Operatorët Ekonomike duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës, të certifikuar të pakten:

2.3.6/a-1 (nje) Punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqes kontratë pune, certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën 3 (tre) muajt e fundit.

2.3.6/b-1 (nje) Punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim” në përputhje me Ligjin Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes

nga zjarri dhe per shpetimin”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate leshuar nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhën 3 (tre) muajt e fundit. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim”.

Per te permbushur kete kriter duhet te paraqitet kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën 3 (tre) muajt e fundit.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

2.3.7 Operatorët Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-2 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
2	Kamioncine me kapacitet mbajtes mbajtes nga 3.5 deri ne 5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
3	Skele e levizshme h-6 m	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	4
4	Kompresor per lyerje	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	4

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqërohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit: - certifikaten e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe te jetë e dukshme targa e mjetit.

- Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases/ bashkepunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatëse, ndersa per mjete te marra me qera/ Kontrate bashkepunimi, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatëse te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma ”ç” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe paisjet teknike të nevojshme për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

2.3.8 Operatorët Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 45001:2018**, mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurise në punë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 14001:2015**, mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalentin e saj.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenet 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron qëndrueshmërinë e shërbimeve, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e çertifikatave të kërkuara më sipër është bërë mbështetur në specifikimet teknike, termave të references dhe në varësi të zërave përkatës të shërbimit objekt prokurimi. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të çertifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike duhet të paraqesë skedat teknike si dhe raportet e testimi nga laboratorë të akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara për bojrat dhe diluentin .

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti CE sipas aneksit III të rregullores EU No.305/2011 për bojrat.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi, shoqeruar me Çertifikatë ISO 9001-2015 të prodhuesit. Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij
- Operatori ekonomik ofertues me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike duhet të paraqesë skedat teknike si dhe raportet e testimi nga laboratorë të akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara për mallrat objekt prokurimi.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, mostra të të gjithë mallrave, objekt prokurimi (referoju shtojcës 2) në ambalazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.

a- Bojë Akrilike Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponenteve organike të paqëndrueshëm (VOC), ku emetimi të jete jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C < 1000 g/m³. - ISO 6504-3 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese të bojës, ku fuqia mbuluese të jete ISO 11998 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj larjes. Duhet të paraqiten: Kataloget/skedat teknike të shoqeruara me raportet e testimi nga laboratore të akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente. Certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike.

b- Boje Hidroplastike ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponenteve organikë të paqëndrueshëm (VOC), ku emetimi të jetë jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C < 1000 g/m³. - SSH EN ISO 6504-3:2007 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.- SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj fërkimit të lagësht, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e II-të. Duhet të paraqiten: Kataloget/skedat teknike të shoqeruara me raportet e testimi nga laboratore të akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente Certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike dhe antibakteriale.

c- Bojë hidromat Boja hidromat të jetë me bazë rezinë vinilike, e cila shërben për përdorim të brendshëm, për sipërfaqe muresh apo tavanesh. Të ketë mbulim të mirë dhe aplikim të lehtë Natyra e lidhësit: Kopolimer (rezinë) vinilike Viskoiteti: 100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente Norma e hapjes: > 15m² / litër (me një shtresë trashësi filmi 80-100µm), Pësia specifike: 1.5 ± 0.2 kg/litër Standartet Teknike që duhet të përmbushë: Përmbajtja e VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm): ≤ 10g/l sipas Vendimit të Komisionit Europian datë 28 Maj 2014 “Për vendosjen e kriterëve ekologjike për dhënien e etiketës ekologjike të BE-së për bojërat dhe llaqet e brendshme dhe të jashtme.

Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimi nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron qëndrueshmërinë e shërbimeve, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e çertifikatave të kërkuara më sipër është bërë mbështetur në specifikimet teknike, termave të references dhe në varësi të zërave përkatës të shërbimit objekt prokurimi. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të çertifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

Shënim: Në respektim të LPP, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalente”

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Afati i kryerjes së shërbimit:

- 14 (katërmëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës për arsye të mirefunksionimit të parkimeve nëntokësor Sheshi “Skënderbej” dhe Sheshi “Bulevardi i Ri” dhe për të shmangur diskomfortin e qytetarëve lidhur me parkimin në qytet.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.